



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0970

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani - Anëtar dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Gëzime S. Gashi B.I” - kundër Vendimin për dhënie të një kontratë “Kuvendi i Komunës së Prishtinës ” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1, me 09.01.2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e OE “Gëzime S. Gashi B.I” me nr. 2023/0970 , e datës 04/12/2023, kurse vendimi i AK “Kuvendi i Komunës së Prishtinës ” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Gëzime S. Gashi B.I”.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.06.2023, “Gëzime S. Gashi B.I” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me pelet” Ndërsa

me datën 16.11.2023 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “DHF Company SHPK”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 438,000.00 €.

Me 21.11.2023, OE “Gëzime S. Gashi B.I” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 24.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 04/12/2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gëzime S. Gashi B.I” me nr. 970/23 lidhur me aktivitetin “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-23-6338-1-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi B.I” janë parashtruar si në vijim:

-Pretendimet e Operatorit Ekonomik: “Në këtë aktivitet të prokurimit kanë ofertuar gjithsejtë 12 operatorë ekonomik. Në vlerësimin e parë ishte rekomanduar për kontratë OE DHF Company SHPK” me çmim prej 237,744.00 €. Neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm. Pas këtij njoftimi mbi vendimin, ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim dhe më pastaj ankesë në OSHP me pretendime se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm. Ne lidhje me ankesën tonë ishte lëshuar ekspertiza e ekspertit shqyrtues e dt.09.10.2023 me nr. 2023/0733 i cili kishte rekomanduar që lënda të kthehet në rivlerësim dhe të kërkohen sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me dëshmitë për vlerën e kontratave. Po ashtu edhe paneli shqyrtues me vendimin Nr.2023/0733 të dt.02.11.2023 kishte vendosur që lënda të kthehet në rivlerësim dhe që të sqarohen dëshmitë e OE të rekomanduar për kontratë që kanë të bëjnë me kontrata dhe referencat. Pas kthimit të lëndës në rivlerësim, autoriteti kontraktues ka vepruar njëjtë duke e favorizuar OE e rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët. Autoriteti kontraktues ka nxjerr njoftimin mbi vendimin e ri me dt.16.11.2023, ku përsëri është rekomanduar për kontratë i njëjti operator ekonomik DHF Company SHPK. Pas pranimit të këtij njoftimi, ne kemi kërkuar qasje në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë dhe kemi vërejtur se këtij OE i janë kërkuar sqarime shtesë në lidhje me referencat dhe vlerën e kontratave të natyrës së ngjashme. Edhe në këtë vlerësim Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit në Komunën e Prishtinës nuk i kanë

zbatuar parimet e prokurimit publik veçanërisht objektivitetin dhe nuk kanë pasur parasysh qëllimin e LPP-së. Po ashtu nuk i kanë zbatuar më përpikëri edhe kërkesat e vendimit të OSHP-së me nr. OSHP: 2023/0733 për rivlerësimin e ofertave. Veprimet e autoritetit kontraktues duke e favorizuar OE e rekomanduar me çdo kusht janë plotësisht në kundërshtim me mirëqenien e nxënësve të shkollave dhe fëmijëve në kopshte. Në Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 08.11.2023 e cila i është drejtuar OE “DHF COMPANY” SH.P.K, është kërkuar që të dorëzohen këto dokumente, **citim** “Bazuar në nenin 72 të LPP-se kërkojmë nga ju që të dorëzoni: 1. Kontratat, 2. Referencat, 3. Dëshmitë e pagesave përmes bankës të nënvizuara ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve sipas listës së kontratave të dorëzuara sipas Aneksit 6 dhe DT-së (Në referenca duhet të jenë shumat e vlerave në euro (€) të kontraktuara, fillimi dhe mbarimi i furnizimit.) jo me pak se 400.000.00 €” **mbarim citati**. OE “DHF Company SHPK” në listën e furnizimeve në tri vitet e fundit ka listuar furnizimet e realizuar në shumën 400,000.00 € me këta OE: Ahmetaj Group SHPK – furnizimet e realizuar sipas listës së furnizimeve në tri vitet e fundit 187,895.65 €; Jusaj Metal SHPK – furnizimet e realizuar sipas listës së furnizimeve në tri vitet e fundit 163,730.03 €; dhe Lira – M NPT – furnizimet e realizuar sipas listës së furnizimeve në tri vitet e fundit 89,567.16 €. Fillimisht ju sqarojmë se kontrata që janë realizuar me furnizim me naftë nuk janë kontrata të natyrës së ngjashme, sepse të ngjashme janë kontrata që kanë të bëjnë me dru dhe pelet, e jo kontrata me derivate siç janë nafta, benzina etj. Kontrata dhe referencat në të cilat është mbështetur OE i rekomanduar për kontratë dhe të cilat i ka marr parasysh autoriteti kontraktues, e që realisht nuk është dashur të merren parasysh janë si në vijim:

Kontrata me “AHMETAJ GROUP SHPK” Gjatë shqyrtimit të dëshmimeve të ofruar nga OE DHF Company SHPK me sqarime për procesin e rivlerësimit kemi vërejtur së qarkullimi bankar për kontrata e pretenduara të realizuara nuk janë dëshmuar me dëshmi që dëshmojnë vërtetësinë e realizimit të kontratave dhe shumave të qarkullimit të prezantuara në listën e furnizimeve dhe referencat e dorëzuara me dosjen e tenderit. Edhe pse në Letrën Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 08.11.2023 e cila i është drejtuar OE “DHF COMPANY” SH.P.K, janë kërkuar dëshmitë e pagesave përmes bankës të nënvizuara ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve sipas listës së kontratave, OE DHF Company SHPK nuk i ka dorëzuar këto dëshmi të furnizimeve të realizuara me OE Ahmetaj Group SHPK të konfirmuara nga banka ashtu siç janë kërkuar nga AK. Dokumenti i ofruar nga OE DHF Company SHPK për ta konfirmuar furnizimin e realizuar për OE Ahmetaj Group SHPK me titull “Qarkullimi në periudhën nga 20.04.2021 deri me 10.08.2022” nuk është dokument i besueshëm për arsye se nuk është i vulosur dhe as i nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës të bankës. Mund të konvertohet në word dhe të plotësohet dhe ndryshohet, pra nuk është i skanuar. Po ashtu në këtë dokument thuhet së përfituesi është OE Ahmetaj Group SHPK (që në kontratë është blerësi) dhe jo OE DHF Company SHPK (që në kontratë është shitësi) dhe kjo është në kundërshtim më atë që është kërkuar. Për më tepër kriteri i gjendjes ekonomike dhe financiare në dosjen e tenderit është kërkuar të plotësohet nga pjesëmarrësit në tender, në rastin konkret OE DHF Company SHPK i rekomanduar për dhënien e kontratës dhe jo nga OE që nuk kanë marr pjesë në tender siç është rasti me Ahmetaj Group SHPK. Përveç kësaj shuma e qarkullimit e prezantuar në këto dy

dokumente kinse të marra nga banka është **149,552.00 €**, që nuk është e njëjta shumë e qarkullimit të cilën OE DHF Company e ka prezantuar në listen e furnizimeve të realizuara në tri vitet e fundit me OE Ahmetaj Group SHPK prej **187,895.65 €**. Formatin e dokumentit për qarkullim bankar të ofruar nga OE DHF Company SHPK, i cili mban llogon e Bankës NLB e kemi krahasuar edhe me dëshminë e qarkullimit të cilën na e ka lëshuar banka NLB neve si OE dhe kemi vërejtur se ka dallime substanciale në mes të dy dokumenteve të lëshuar nga banka e njëjtë për qëllimin e njëjtë! Kontrata e nënshkruar në mes të OE DHF Company SHPK dhe Ahmetaj Group SHPK është po ashtu jo bindëse ngase nuk e përmban emrin e personit të autorizuar për nënshkrimin e kontratës në emër të OE Ahmetaj Group SHPK. Pra nuk ka emër e mbiemër se nga kush është nënshkruar, prandaj duhet verifikuar nëse është valide kjo kontratë. Kundërthëniet dokumenteve tregojnë se këto dëshmi nuk mund të merren parasysh sepse nuk plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Kontrata figuron se është nënshkruar me dt. 29.03.2019, dhe është lidhur për tri vite me mundësi vazhdimi. Kontrata i bie se ka qenë valide deri në fund të Marsit 2022. Referenca shkruan se është lëshuar për periudhën 01.05.2020 deri me 30.04.2023 është 187,895.65 Euro. Në listë është e shënuar periudha e përfundimit të kontratës 01.05.2020 deri me 30.04.2023 është 187,895.65 Euro. Referenca rezulton se nuk është e lëshuar për kontratën e prezantuar, sepse janë periudha të tjera të furnizimit. Nuk ekziston asnjë referencë për periudhën mars 2019-mars 2022 siç ka qenë e lidhur kontrata në fjalë. Po ashtu nuk ka asnjë aneks të kontratës që do të dëshmonte se ka një lidhshmëri me kontratën bazë. Në këtë rast rezulton se lista e kontratave nuk përmbush kërkesat e dosjes së tenderit dhe duhet refuzuar tenderin. Pra nuk janë ofruar dëshmitë konkrete në lidhje me kontratat që janë listuar në listë. Dokumenti i lëshuar kinse nga NLB Banka për qarkullim nuk përputhet fare shuma e transaksioneve me vlerën e cekur në listë dhe vlerën në referencë. Për më tepër në dokumentin e NLB Bank nuk është asnjë transaksion që është bërë në vitin 2019. Me këtë kuptohet se për kontratën që është prezantuar nuk ka dëshmi se është përfunduar. Po ashtu në këtë dokument në disa raste nuk shkruan se kujt i është bërë pagesë sikurse në numrin rendor 1, 3 dhe 4 të qarkullimit nga dt. 01.01.2020 deri 31.12.2020. Po ashtu tek qarkullimi nga dt. 20.04.2021 deri 10.08.2022, nuk figuron se kujt i është bërë pagesa sikurse në numrin rendor 5, 7, 12 dhe 14, prandaj këto transaksione edhe nëse janë të vërteta nuk mund të merren parasysh, sepse nuk dihet se kujt i janë bërë dhe më pastaj se për çfarë janë bërë këto pagesa. Pra edhe me sqarime OE i rekomanduar për kontratë nuk ka arrit të dëshmojë se e përmbush kërkesën e dosjes së tenderit. Ofrimi i dëshmimeve të tjera me kompani private nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive ekzistenca e këtyre dokumenteve siç janë kontratat, referencat e dëshmi të tjera që lëshohen vetëm nga kompania. Kontrata dhe dëshmitë e ofruara në lidhje me kompaninë Ahmetaj Grup SHPK, përveç se nuk janë të natyrës së ngjashme, nuk mund të merren parasysh sepse janë edhe dokumente jo valide dhe nuk përputhen njëra me tjetrën.

Kontrata me “JUSAJ METAL SHPK” Në dokumentin “Listen e furnizimeve në tri vitet e fundit” që e ka dorëzuar OE DHF Company SHPK, OE i dytë për nga madhësia e qarkullimit të realizuar është OE Jusaj Metal SHPK. Në përgjigje të Letrës Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 08.11.2023 e cila i është drejtuar OE “DHF COMPANY” SH.P.K, OE DHF Company SHPK për OE Jusaj Metal SHPK ka ofruar si dëshmi të qarkullimit një

dokument në excel kinse të lëshuar nga banka Raiffasien. Dëshmia e qarkullimit në excel nuk është dëshmi që konfirmon vërtetësinë e qarkullimit të prezantuar në listën e furnizimeve dhe si e tillë nuk do të duhej të merret si dëshmi e vërtetë, por do duhej të hidhet poshtë nga Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit si dokument i pa certifikuar dhe i pa konfirmuar nga banka. Sipas këtij dokument në excel që është ofruar nga OE DHF Company SHPK pagesat që i ka bërë OE Jusaj Metal SHPK ndaj OE DHF Company janë 27,940.33 €. Edhe edhe po qëse do të ishte dokument zyrtar, i vulosur dhe i nënshkruar nga banka, shuma e qarkullimit nuk është e njëjtë me shumën e qarkullimit të cilën OE DHF Company SHPK e ka deklaruar në listenë e furnizimeve të realizuara në tri vitet e fundit me OE Jusaj Metal SHPK që është 163,730.03 €. Përveç kësaj edhe kontrata që është nënshkruar midis OE DHF Company SHPK dhe OE Jusaj Metal SHPK nuk e përmban emrin e përfaqësuesit të OE Jusaj Metal SHPK. Gjithashtu, kur krahasohen nënshkrimet e përfaqësuesit të OE Jusaj Metal SHPK në referencën dhe kontratën për/dhe me OE DHF Company SHPK vërehet që nuk është i njëjti nënshkrim dhe kjo ngrit edhe më shumë dyshimet së këto dokumente janë fiktive. Prandaj kërkojmë të verifikohen nga OSHP-ja. Edhe në këtë rast ka dëshmi kundërtëse dhe jo në përputhje me njëra tjetrën lidhur me vlerën e qarkullimit dhe kohën e qarkullimit përkatësisht realizimit të kontratës. Në listë dhe referencë shkruan Qarkullimi për periudhën 01.05.2020 deri me 30.04.2023 është 163,730.03 Euro. Në kartelën financiare të hartuar nga vetë Jusaj figuron se fatura janë bërë dhe paguar prej dt. 31.05.2020, kurse dokumenti që është prezantua si i Bankës figuron se pagesa e parë është bërë për DHF me dt.27.09.2020, prandaj në këtë rast shihet qartë manipulimi i dëshmimeve të përpiluara nga vetë OE i rekomanduar për kontratë. Kontrata figuron se është nënshkruar me dt.17.12.2019, ndërsa tek lista është shënuar realizimi nga dt.01.05.2020-30.04.2022, si të gjithë kontratat tjera të cekura në listë. Edhe në referencë shkruan si në vijim "Qarkullimi për periudhën 01.05.2020 deri me 30.04.2023 është 163,730.03 Euro". Në këtë rast nuk ka përputhje të referencës me kontratën, prandaj mund të themi lirisht se kjo referencë nuk është për kontratën e prezantuar sepse nuk përputhen datat dhe në referencë nuk ka asnjë shënim më shumë se për cilën kontratë bëhet fjalë. Këto dëshmi janë të pavlefshme dhe nuk duhet të merren parasysh sidomos kur kem parasysh faktin se edhe me sqarime nuk ka mundur ti dëshmojë kontratat e listuara në listë. Nga këto dëshmi vërehen mospërputhjet e dëshmimeve edhe pse vetë OE i ka dorëzuar me sqarime.

Kontrata me OE LIRA – M NPT Edhe OE Lira – M NPT është prezantuar si OE i tretë për nga vlera e qarkullimit përkatësisht realizimit të kontratave, më të cilin kinse ka realizuar furnizime OE DHF Company SHPK. Të metat e njëjta janë vërejtur edhe në dëshmitë që janë ofruar për OE Lira – M NPT në përgjigje të Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 08.11.2023 të cilën Sektori i Prokurimit ja ka drejtuar DHF Company SHPK. Nuk është ofruar dëshmi e vulosur dhe e nënshkruar nga banka për qarkullimin e prezantuar për OE Lira – M NPT në Listën e Furnizimeve në tri vitet e fundit, por janë ofruar disa dokumente me titull detajet e transaksionit, të cilat janë të konvertueshme në word dhe në të cilat mund të ndryshohen të dhënat. Pra këto dokumente janë të dyshimta dhe nuk konfirmojnë vërtetësinë e qarkullimit të deklaruar që është realizuar me OE Lira-M SHPK sipas Listës së furnizimeve në tri vitet e fundit të OE DHF Company SHPK. Të metat e njëjta janë vërejtur edhe të kontrata që është

nënshkruar midis OE DHF Company SHPK dhe OE Lira – M NPT, pra kontrata nuk e përmban emrin e përfaqësuesit të OE Lira – M NPT dhe kur krahasohen nënshkrimet e përfaqësuesit të OE Lira – M NPT në referencën dhe kontratën për/dhe me OE DHF Company SHPK vërehet që nuk është i njëjti nënshkrim dhe kjo ngrit edhe më shumë dyshimet së këto dokumente janë fiktive.! Kontrata e ofruar si dëshmi shkruan se është nënshkruar me dt.07.12.2017 për një periudhe trevjeçare me mundësi vazhdimi edhe për tri vite. Nga ky fakt kuptohet se kjo kontratë ka përfunduar me dt.07.12.2020 dhe nuk ka asnjë dëshmi për realizimin e kësaj kontrate. Referenca e prezantuar shënon se Qarkullimi për periudhën 01.05.2020 deri me 30.04.2023 është 89,567.16 Euro”. Janë ofruar disa transaksione të dyshimta, edhe pse në këto transaksione askund nuk ceket se për çfarë dhe për çka bëhen pagesat. Pavarësisht të gjitha këtyre pretendimeve dhe dëshmimeve të dyshimta, e që nuk përputhen njëra me tjetrën, edhe po të ishin këto transaksione të vërteta nuk përputhen me kontratën që e ka ofruar vetë OE i rekomanduar për kontratë, sepse transaksionet janë për periudhën 2020-2023, kurse kontrata është nënshkruar në vitin 2017 dhe normalisht ka përfunduar me 2020. Përderisa nuk ka arrit ti sqarohet dhe dëshmojë vlerën e kontratave OE i rekomanduar për kontratë edhe pas sqarimeve shtesë, atëherë është qartë e kuptueshme se ky OE është i papërgjegjshëm dhe është dashur të eliminohet nga konkurrenca e jo të rekomandohet për kontratë. Për të tre këta operator ekonomik DHF Company SHPK ka ofruar edhe kartela të qarkullimit me ta, mirëpo këto kartela nuk japin informata të sakta, sepse janë përgatit nga vet OE DHF Company SHPK dhe nuk janë të konfirmuara nga OE dhe as nga bankat e tyre. Për asnjërin nga OE që janë të prezantuar në Listën e furnizimeve të realizuara në tri vitet e fundit të cilën OE DHF Company SHPK e ka dorëzuar në dosjen e tenderit nuk janë ofruar dëshmi të qarkullimit nga bankat dhe kjo e rikonfirmon dyshimin tonë së DHF Company SHPK nuk ka realizuar kontrata në vlerën e kërkuar në dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” Sipas mendimit tonë, gjatë procesit të rivlerësimit të ofertave për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” kanë ndodh shkelje edhe më të rënda të Ligjit për Prokurim Publik, duke i pranuar si dëshmi dokumentet që nuk janë të lëshuara dhe konfirmuara nga autoritetet kompetente në këtë rast banka. Përveç këtyre mangësive të vërejtura në dokumentet e cekura më lartë, ne po ashtu kemi vërejtur së veprimtaria e OE DHF Company SHPK është e ndryshme dhe në kundërshtim me FPP të përcaktuar në dosjen e tenderit për “Furnizim me pelet”. Në nenin 27 “Dosja e tenderit”, paragrafin 3, i LPP ceket qartë që “Pa marrë parasysh se a kërkohet dosja e tenderit apo jo, furnizimet, shërbimet apo punët sipas kontratës duhet të përshkruhet me anë të fjalorit të përgjithshëm të prokurimit dhe kodeve të duhura. Po ashtu kjo parashihet edhe në nenin 17 paragrafin 21 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurim Publik, ku thuhet se furnizimet, shërbimet dhe punët që janë lëndë e kontratës duhet të përshkruhen me fjalorin e përgjithshëm të prokurimit (FPP) dhe kodeve të duhura. Kodi i duhur për furnizim me pelet sipas FPP 20161000-2 është i ndryshëm me kodin e lëndës djegëse për të cilin i janë pranuar OE DHF Company furnizimet si të ngjashme në tri vitet e fundit. Rrjedhimisht sipas opinionit të KRPP-së të datës 09.06.2013 si bazë për të përcaktuar termin “të ngjashme” përdoret edhe FPP. Në rastin konkret për lëndën e kontratës “Furnizim me pelet”, FPP është 20161000-2, ndërsa referencat dhe lista e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit të ofruara nga OE DHF Company, kategorizohen në FPP 23000000-7. Kjo do të thotë se ka dallime të mëdha ndërmjet

kontratave me pelet dhe të ngjashme që mund të jenë edhe kontrata me dru, në krahasim me kontratat me karburante siç janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë. Pra, K.K. Prishtinë nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe opinionin e KRPP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” dhe ka pranuar si furnizime të ngjashme listën e kontratave të kategorisë furnizim me karburante . Ndryshimet janë të madha ndërmjet peletit dhe karburanteve, madje edhe kaldatë janë të ndryshme dhe nuk mund të shërbejë kaldaja për pelet edhe për karburante. Kontrata të ngjashme me peletin mund të jenë kontrata me dru sepse janë përbërje përafërsisht e njëjtë, kurse nafta dhe karburantet tjera janë natyrë tjetër dhe nuk mund të konsiderohen të ngjashme me peletin. Me dt. 24.11.2023 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, e ku ky vendim nuk përmban asnjë arsytim konkret në lidhje me pretendimet tona ankimore. Ky veprim i AK-së përbën shkelje të nenit 108/A paragrafi 9 i LPP-së, ku shkruan:

1. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komunikohet me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim. Vendimi i OSHP-së ka konstatuar se duhet të kthehet lënda në rivlerësim dhe të kërkohen sqarime shtesë, ndërsa vendimi i OSHP-së nuk ka orientuar autoritetin kontraktues se duhet të merren parasysh çfarëdo dëshmie që ofron OE i rekomanduar për kontratë. Sqarimet mund të kërkohen sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së mirëpo dëshmitë që ofrohen nga operatorët ekonomik, në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë nuk duhet të merren si të vlefshme dhe valide nëse nuk janë reale dhe nëse nuk janë në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Siç e kemi cekur edhe më lartë, dëshmitë shtesë që janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit dhe nuk korrespondojnë njëra me tjetrën, janë jashtë tri viteve të fundit, në disa raste nuk dihen pagesat për kënd janë bërë, janë të dyshimta dhe përfundimisht nuk plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Prandaj neni 72 i LPP-së është përdor në mënyrë favorizuese në drejtim të OE të rekomanduar për kontratë. Duke pasur parasysh të gjitha mangësitë dhe të metat e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, rezulton se oferta e tij është e papërgjegjshme, ndërsa kur duhet të konsiderohet oferta e përgjegjshme e cek qartë edhe neni 40.6 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ku përcaktohet si në vijim: 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: **a.** është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; **b.** është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; **c.** është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit. Pra, K.K. Prishtinë nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe opinionin e KRPP-së lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet” dhe ka pranuar si furnizime të ngjashme listën e kontratave të kategorisë furnizim me karburante. Ndryshimet janë të madha ndërmjet peletit dhe karburanteve, madje edhe kaldatë janë të ndryshme dhe nuk mund të shërbejë kaldaja për pelet edhe për karburante. Kontrata të ngjashme me peletin mund të jenë kontrata me dru sepse janë përbërje përafërsisht e njëjtë, kurse nafta dhe karburantet tjera janë natyrë tjetër dhe nuk mund të konsiderohen të ngjashme me peletin. Me dt. 24.11.2023 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, e ku ky vendim nuk përmban asnjë arsytim konkret në lidhje me pretendimet tona ankimore. Ky

veprim i AK-së përbën shkelje të nenit 108/A paragrafi 9 i LPP-së, ku shkruan: 1. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim. Pra vendimi për refuzim nuk është arsyetuar fare, por i njëjti i është referuar vetëm vendimit të OSHP-së, duke e cekur që janë kërkuar sqarime sipas vendimit të OSHP-së. Vendimi i OSHP-së ka konstatuar se duhet të kthehet lënda në rivlerësim dhe të kërkohen sqarime shtesë, ndërsa vendimi i OSHP-së nuk ka orientuar autoritetin kontraktues se duhet të merren parasysh çfarëdo dëshmie që ofron OE i rekomanduar për kontratë. Sqarimet mund të kërkohen sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së mirëpo dëshmitë që ofrohen nga operatorët ekonomik, në këtë rast OE i rekomanduar për kontratë nuk duhet të merren si të vlefshme dhe valide nëse nuk janë reale dhe nëse nuk janë në përputhje me kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Siç e kemi cekur edhe më lartë, dëshmitë shtesë që janë ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk janë në harmoni me kërkesën e dosjes së tenderit dhe nuk korrespondojnë njëra me tjetrën, janë jashtë tri viteve të fundit, në disa raste nuk dihen pagesat për kënd janë bërë, janë të dyshimta dhe përfundimisht nuk plotësojnë kërkesën e dosjes së tenderit. Prandaj neni 72 i LPP-së është përdorur në mënyrë favorizuese në drejtim të OE të rekomanduar për kontratë.

Duke pasur parasysh të gjitha mangësitë dhe të metat e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, rezulton se oferta e tij është e papërgjegjshme, ndërsa kur duhet të konsiderohet oferta e përgjegjshme e cek qartë edhe neni 40.6 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik, ku përcaktohet si në vijim: 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur: **a.** është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit; **b.** është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; **c.** është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë është e papërgjegjshme në aspektin administrativ dhe teknik. Dëshmitë e ofruara nga ky operator ekonomik dallojnë esencialisht nga kushtet dhe kriteret e dosjes së tenderit. Rekomandimi për kontratë nuk është bërë në harmoni edhe me nenin 56 të LPP-së sepse nuk janë marr për bazë kriteret e përzgjedhjes ashtu siç parashihet në këtë dispozitë. Ligjërisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka asnjë mundësi të shpërblehet me kontratë pasi që edhe neni 25 i Rregullorës Nr.001/2022 Për Prokurim Publik e parasheh qartë se kur mund të konsiderohet i kualifikuar një Operator ekonomik. Neni 25.1 Sipas Nenit 56 të LPP, një OE do të konsiderohet i kualifikuar për pjesëmarrje në aktivitet të prokurimit nëse: **a.** Një OE vërteton të jetë i përshtatshëm sipas nenit 65 të LPP-së duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues dhe **b.** Një OE i tillë, në rast që AK ka përcaktuar kërkesa minimale për kualifikim, përmbush kërkesat e tilla dhe e dëshmon atë duke ofruar dëshmi të kërkuara nga autoriteti kontraktues në përputhshmëri me nenet 64 deri në 69 të LPP-së. Po ashtu dispozitat e mëposhtme të Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik përcaktojnë si në vijim: Neni 25.2 Kërkesat e pranueshmërisë, gjithnjë duhet të përmbushen nga OE. 25.5

Kriteret e përzgjedhjes: a. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës b. nuk mund të kenë peshë të caktuara; c. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon. Pra në bazë të dëshmitë të cekura më lartë, rezulton qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka përmbush kërkesat minimale për kualifikim, prandaj është dashur të shpallet i papërgjegjshëm. Pra kriteret e përzgjedhjes janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon, ndërsa në këtë rast këto kërkesa nuk janë përmbushur nga OE i rekomanduar për kontratë, prandaj oferta e tij nuk duhet të kalojë më tutje. Këtë fakt e qartëson edhe Udhëzuesi Nr.001/2023 Për Prokurim Publik ku në nenin 8.5 përcakton qartë: 8.5 Kriteret e përzgjedhjes: i. në asnjë mënyrë nuk mund të përdorën si kritere të dhënies së kontratës ii. nuk mund të kenë peshë të caktuara; iii. ato janë kërkesa të vlerësimit Kalon/Nuk kalon Njëra ose tjetra Kërkesat janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë janë ende në konsideratë, ose Kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderët e dorëzuar nga tenderues të tillë do të refuzohen menjëherë Në rastin konkret kërkesat nuk janë përmbushur dhe tenderi i OE të rekomanduar për kontratë është dashur të refuzohet menjëherë.

Duke u bazuar në te gjitha dëshmitë dhe faktet që u ceken më lartë, konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë. Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm. Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka respektuar nenin 72 të LPP-së në mënyrë të drejtë, por është përdor në mënyrë të njëanshme dhe favorizuese, duke kërkuar sqarime edhe pse dëshmitë dhe faktet kanë qenë të qarta se OE i rekomanduar për kontratë nuk i plotëson kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse ne jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”.

Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që “Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse”, kurse grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pra është vepruar në kundërshtim me dispozitën e lartcekur. Gjatë zhvillimit të kësaj procedure nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Gëzime S. Gashi B.I”. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 7, 56, 59, 60, 69, 72 të LPP-së, nenin 40 I rregullores nr.001/2022 për prokurim publik, nenin 8 udhëzuesit nr.001/2022 për prokurim publik dhe

vendimi i OSHP-së 2023/0733. Duke propozuar që të Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Rron 2019 & N.P.T “Meti Comerc” Të Anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera me të larta.

Përgjigjja e AK-së ndaj kërkesës për rishqyrtim. “Operatori ekonomik “Rron 2019” (tutje “parashtruesi”) me datë 21.11.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin të datës 16.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit 616-236338-1-1-1. Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritum (in meritum) të kërkesës. Pretendimet kryesore të parashtruesit janë se OE që i është dhënë kontratë dhe kemi gjetur se OE DHF Company nuk i ka dorëzuar kontratat për furnizime të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 400.000,00 euro. Fillimisht duhet cekur se pretendimi ka të bëjë me kërkesën vlerësuese të dosjes së tenderit: Nga administrimi i ofertës së tenderuesit të rekomanduar si provë në këtë rast është gjetur se i njëjti ka dorëzuar dëshminë e kërkuar dokumentare “listën e kontratave të realizuara duke plotësuar aneksin 6 të dosjes së tenderit...(në 3 vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë jo më pak se 400,000.00 euro)”. Përndryshe nga formulimi i pretendimit mund të konfirmohet se as vet parashtruesi nuk e konteston që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar listën e kontratave. Sidoqoftë Autoriteti Kontraktues në përputhje edhe me vendimin e OSHP 733/23 ka dërguar një letër standarde për sqarime shtesë për tenderuesin e rekomanduar i Cili është përgjigjur në këtë kërkesë duke dërguar edhe dokumentet shtesë të kërkuara si dëshmi pikërisht për listën e kontratave sipas kërkesës përkatëse të dosjes së tenderit. Në këtë mënyrë sipas vendimit të OSHP është kryer rivlerësimi në përputhje me LPP dhe RRPP si dhe janë kërkuar sqarimet shtesë të nevojshme. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet ankimore janë të pabazuara. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/12/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 970/23, ndërsa me datë 18/12/2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0970 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Për të cilën nuk kanë kthyer përgjigje.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Gëzime S. Gashi B.P”. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 202/0970 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i ekspertës shqyrtueses lidhur me pretendimet ankimore: “OE ankues, si palë e pakënaqur, ka parashtruar ankesë në OSHP, me pretendimin se AK-ja nuk e ka respektuar e vendimin nr. 733/23 dhe kryesisht sikurse në ankesën e pare i konteston kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontrate për të cilat deklaroi se janë fiktive. Eksperti shqyrtues sqaron se pas vendimit të PSH-se nr. 733/23, AK-ja e ka kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit me titull: Furnizim me pelet me nr. të prokurimit: 616-23-6338-1-1-1, ku ka kërkuar sqarime për kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontratë.

Në përgjigje OE i rekomanduar për kontrate i ka dorëzuar kontratat, referencat dhe disa qarkullime bankare me operatorë ekonomik privat (kontrate e lidhur në mes të OE të rekomanduar për kontrate me OE Ahmetaj Group, pastaj me OE Jusaj Metal, Lira -M etj). OE ankues në ankesën e tij i konteston veç e veç kontratat, referencat dhe qarkullime bankare, për të cilat pretendon se kontratat e OE të rekomanduar për kontrate janë fiktive vetëm si dëshmi për ta mbuluar kërkesën e dosjes së tenderit. Eksperti shqyrtues, pasi ka analizuar kontratat dhe referencat e OE të rekomanduar për kontrate të dorëzuara në platformën e E-Prokurimit gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave me ç’rast AK-Komuna e Prishtinës pas analizimit të dëshmitë e ka rekomanduar për kontrate, eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja, nuk e ka përfunduar procesin e vlerësimit të dëshmitë sipas nenit 59 të LPP-së, sepse eksperti shqyrtues gjatë analizimit të kontratave ka vërejtur se kontrata e lidhur me datën: 07.12.2017 në mes të OE DHF dhe OE Lira – M, në pjesën hyrëse të kontratës thuhet: E lidhur në Pejë, me date: 07.12.2017, ndërmjet palëve kontraktuese në vijim: DHF Company Shpk, me numër unik identifikues 810746670 dhe Lira – M.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në ligjin 06/L-016, sqaron se në vitin 2017 nuk ka pasur numra unik identifikues, kjo vërtetohet nga fakti se në paragrafin 4 të nenit 266 të këtij ligji thuhet: Gjatë periudhës tranzitore tre (3) vjeçare, ARBK obligohet të pajisë të gjitha Shoqëritë Tregtare

ekzistuese me numër unik. Ligj i cili ka hyr ne fuqi me datën: 24.05.2018. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se procesi i vlerësimit të këtyre dëshmime nuk është bere ne harmoni të plot me nenin 59 dhe 72 të LPP-se. Poashtu lidhur me këtë çështje eksperti shqyrtues vlerëson se ka edhe kontrata tjera të cilat janë para datës kur OE i rekomanduar për kontratë është pajisur me certifikat të re. Gjithashtu sipas Udhëzimit Administrative Nr. 01/2019 të Qeverise se Republikës se Kosovës të datës: 03.04.2019 janë përcaktuar afatet për transfer të numrave të bizneseve, konkretisht ne nenin 11 të këtij Udhëzimi Administrative. Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi i OE ankues sepse është dashur të verifikohet gjendja ne të cilën është pasqyruar kontrata se si operatori ekonomik e ka pasur numrin unik ne vitin 2017. Poashtu edhe disa kontrata tjera janë para datës se hyrjes ne fuqi të Udhëzimit Administrative Nr. 01/2019 me te cilin janë obliguar operatoret ekonomik ti ndërrojnë numrat unik. Eksperti shqyrtues, mbi bazën e të dhënave ne dëshmitë e prezantuara vlerëson se është e nevojshme te bëhen verifikime te dëshmime sepse janë kontradiktore dhe këtë e vërteton fakti se nga shtate (7) referenca të dorëzuara gjashtë (6) prej tyre mbajnë datën e lëshimit: 06.06.2023 dhe vetëm njëra është me datën: 07.06.2023. Në kontratat e prezantuara konkretisht ne kontratën e vitit 2017, ne nenin ku flitet për kohëzgjatjen e kontratës, thuhet se marrëveshja është për tri vite me mundësi vazhdimi edhe për 3 vite tjera dhe nuk ka asnjë dëshmi se kontrata është vazhduar me tutje, ndërsa referenca është lëshuar me datën: 06.06.2023.”

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi B.I” Argumentimi në raportin e ekspertes është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertes. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi B.I” janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Nga sqarimet e dhëna më sipër, konkludohet se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Gëzime S. Gashi B.I”.Argumentimi në raportin e ekspertizës është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet e dhëna mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumentet e tjera.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar.Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me pelet” me numër të prokurimit: 616-23-6338-1-1-1, të anulohet njoftimi për

dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar, duke sugjeruar që aktiviteti i prokurimit me titull “Furnizim me pelet” që gjatë fazës së rivlerësimit, AK të veprojë në pajtim me dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-së, si dhe në pajtim paragrafin 7 të nenit 52 të LPP-së, të kryej një kontroll efektiv për qartësimin e plotë lidhur me vërtetësinë dhe konstatim e saktë të kësaj kontrate lidhur me numrin unik identifikues si dhe kohëzgjatjen e kontratës.

- Përfundim –

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse në të kundërtën do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit me bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Gëzime S. Gashi B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: